

## **Ndërtimi i bazës së të dhënave të infrastrukturës kërkimore-shkencore në Universitetet dhe Qendrat e Kërkimit Shkencor**

Agjencia jonë ka në program edhe hartimin e një baze të dhënash të plotë për infrastrukturën kërkimore-shkencore që gjendet aktualisht në të gjitha Universitetet dhe Qendrat e Kërkimit Shkencor të vendit dhe që tashmë është një domosdoshmëri. Kjo i hap rrugën hartimit nga ana tonë edhe të një Formati Aplikimi që do të shërbejë për aplikimin pranë AKTI-t të kërkesave të Universiteteve, Qendrave dhe institucioneve kërkimore-shkencore, kërkuesve etj. për pajisje laboratorike në drejtim të studimit dhe kërkimit shkencor.

Gjithashtu hartimi i kësaj baze të dhënash të infrastrukturës kërkimore-shkencore do përbëjë edhe pjesën më të rëndësishme nga ana informative të projektit dhe portalit web *EUROACCESS* ( një organizëm ndërkombëtar që mbështet dhe lehtëson lëvizjen dhe punësimin reciprok të kërkuesve në vende të ndryshme) ku Shqipëria u bë anëtare para tre muajve nëpërmjet Agjencisë tonë (AKTI).

Ftohen të gjitha Universitetet, Institucionet dhe Qendrat që kanë aktivitet kërkimor-shkencor për të ngarkuar sa më shpejt të jetë e mundur personat përgjegjës në bazë fakulteti, drejtorie dhe departamenti e sektori për të kryer këtë detyrim të thjeshtë por shumë të rëndësishëm që me siguri është në dobi të kërkimit shkencor në përgjithësi si dhe të vetë këtyre institucioneve e kërkuesve.

Më poshtë do të gjeni edhe një ftesë nga Projekti i vendeve të Ballkanit Perëndimor WBC-INCO.NET me udhëzime për listimin, ngarkimin dhe përditësimin e pajisjeve dhe aparaturave që shërbejnë për kërkimin shkencor në institucionet tuaja.

Çdo institucion, një listë me emërtimet e kësaj infrastrukture duhet ta dërgojë edhe pranë Agjencisë tonë (AKTI) si përgjegjëse dhe përfaqësuese për infrastrukturën kërkimore e shkencore në vend dhe në projektin WBC-INCO.NET.

*Saktori i Teknologjisë dhe Inovacionit  
Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit*



## **Ftesë për të përditësuar/ngarkuar informacionin mbi infrastrukturën tuaj kërkimore, instalimet dhe pajisjet e rëndësishme kërkimore në WBC-INCO.NET**

Të nderuar kolegë,

Ne jemi një ekip ekspertësh që punojmë në kuadër të projektit me financim European **WBC-INCO.NET**. Projekti WBC-INCO.NET që nga nisja e tij më 2008 e deri më tani ka ngritur një platformë të zhvilluar bashkëveprimi ndërmjet Vendeve të Ballkanit Perëndimor, vendeve anëtare të BE-se, vendeve candidate dhe potencial candidate, dhe vendeve të tjera të asociuara Programeve Kuadër për Kërkim&Zhvillim ,dhe Komisionit European. Objektivi kryesor është mbështetja ndaj integritit të Vendeve të Ballkanit Perëndimor në Zonën Europiane të Kërkimit. WBC-INCO.NET ka një portal web të konsoliduar (<http://www.wbc-inco.net>), burim i rëndësishëm informacioni cilësor mbi kërkimin në Vendet e Ballkanit Perëndimor me më tepër se 10000 vizitorë mujor.

Së fundmi ekipi i WBC-INCO.NET ka vënë në dispozicion një shërbim të ri online me qëllim mbledhjen e informacioneve të reja nga institutet kërkimore, universitetet, fakultetet, qendrat e teknologjive dhe kompanitë private mbi infrastrukturën kërkimore të tyre, instalimet dhe pajisjet e rëndësishme kërkimore që ato disponojnë.

### **Lidhja për tek shërbimi i infrastrukturës kërkimore :**

<http://wbc-inco.net/object/infrastructure> : *ky është një link ku janë të listuara pajisjet e infrastrukturës së kërkimit shkencor sipas vendeve të Ballkanit Perëndimor.*

Vitet e kaluara më tepër se 50 institucione kërkimore, universitete, fakultete dhe kompani private nga Vendet e Ballkanit Perëndimor kanë ofruar të dhënat mbi infrastrukturën e tyre kërkimore. Këto të dhëna janë tanimë online. WBC-INCO.NET ofron akses të lehtë mbi të dhënat me interes për komunitetin european kërkimor, ndërsa kërkon partnerë dhe mundësi bashkëpunimi nga Vendet e Ballkanit Perëndimor

### **Për tu përfshirë në bazën e të dhënave:**

- **Gjeni këtu FORMATIN E REGJISTRIMIT ONLINE:**

<http://wbc-inco.net/object/infrastructure/create>

*Ky është një link për regjistrimin online të paisjeve të infrastrukturës së kërkimit shkencor për çdo institucion.*

- Ju duhet të zoteroni një **username** të vlefshëm për WBC-INCO.NET. Nëse nuk zotëroni një të tillë ju duhet të regjistroheni në *webportalin* e WBC-INCO.NET. Pasi të regjistroheni ju do të jeni në gjendje të modifikoni informacionin që ju jepni. Regjistrimi mund të kryhet në linkun: <http://wbc-inco.net/register>

- **Cilat institucione mund të japin informacion:** të gjitha institutet kërkimore, universitetet, fakultetet, qendrat e teknologjisë, kompanitë private, dhe të tjera institucione që kanë infrastrukturë kërkimore, instalime ose pajisje të rëndësishme të instaluara në mjediset e tyre (*instalime kërkimore , koleksione, librari, bazë të dhënash, arkiva biologjike, rrjete komunikimi me kapacitet dhe shpejtësi të lartë, enë kërkimi, teleskopë, instalime observimi sizmiologjik, instalime për testime kimike, instalime rrjetesh kompjuterike, etj.*). Lejohet më tepër se një *input* nga çdo organizatë, nëse disponohet më tepër se një infrastrukturë ose pajisje e rëndësishme kërkimore.

Ju lutemi të mos hezitoni për të na kontaktuar në [office@wbc-inco.net](mailto:office@wbc-inco.net) për cdo pyetje tuajën. Presim informacionin tuaj.

***Ekipi i projektit WBC-INCO.NET***